



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

ABUZIMI DHE VIOLENCA SEKSUALE ONLINE, STRATEGJITË, PASOJAT DHE SFIDAT E TRAJTIMIT

Irena Hysenaj*

**Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme,*

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University

Abstrakt

Përdorimi i shtuar i internetit ka sjellë një rritje të rreziqeve përfshirë abuzimin dhe dhunën seksuale online (OSA). Hulumtimet në Sh.B.A sugjerojnë që 43.6% e grave dhe 24.8% e burrave kanë përjetuar dhunën seksuale (Smith et al., 2018). Forma të ndjekjes ose abuzimit seksual online: dërgimi i kërkesave për të dërguar foto apo video seksuale; shpërndarja e imazheve apo videove private pornografike pa miratimin e palëve pjesëmarrësve, e njohur si “revenge porn”. Trauma e abuzimit online shprehet me stres emocional dhe psikologjik, ndjenja faji, turpi, frikë, ankth, trishtim, mpirje, tronditje, izolim social vështirësi në gjumë, ëndrra të frikshme etj. Kërkimi synon të identifikojë pattern që lidhen me OSA dhe të vlerësojë pasojat traumatike që shkaktojnë.

Fjalë çelës: *abuzim seksual online, trauma, teknika vlerësimi*

ONLINE ABUSE AND SEXUAL VIOLENCE, STRATEGIES, CONSEQUENCES AND CHALLENGES OF TREATMENT

Abstract

Increased internet usage has led to a rise in risks including online sexual abuse and violence (OSA). Research in the United States suggests that 43.6% of women and 24.8% of men have experienced sexual violence (Smith et al., 2018). Forms of online sexual harassment or abuse include: sending requests to send sexual photos or videos; sharing private pornographic images or videos without the consent of the involved parties, known as “revenge porn”. Trauma from online abuse manifests as emotional and psychological stress, feelings of guilt, shame, fear, anxiety, sadness, numbness, shock, social isolation, sleep difficulties, nightmares, etc. The research aims to identify patterns related to OSA and assess the traumatic consequences they cause.

Keywords: *online sexual abuse, trauma, assessment technique*

1. Hyrje

“The Internet is a Godless place”, that’s as close to an “in-the-beginning-was-the-word”

(Tim Berners-Lee)

Kjo frazë u artikulua nga Tim Berners-Lee, krijuesi i Rrjetit Botëror të Internetit (World Wide Web) në ceremoninë e hapjes së Lojërave Olimpikë në Londër, 2012. Parimi që interneti duhet të jetë i lirë në aspektin shoqëror, ekonomik dhe politik, dhe që kushdo dhe kudo duhet të jetë në gjendje ta përdorë për të ndërtuar platforma të reja interaktive, për të zgjeruar kufijtë e dijes njerëzore ose thjesht për të marre pjesë në forume është në vërtetë i shëndetshëm. Është për të gjithë. Ose të paktën, kështu duhej të ishte. Po, a është vetëm kështu? Ka qenë një kohë, jo aq kohë më parë, kur “të mëdhenjtë”, teoricienët dhe hakerët, kolonistët e parë të hapësirës virtuale, besonin se interneti do të na çlironte nga ndrojtja, kufizimet mbrojtëse të identitetit, do të na çlironte nga gjinia (Turkle, 1995). Shkrimtarët e zhanrit të shkencës imagjinonin një të ardhme të afërt në kufi të imagjinatës, ku trupat fizikë të njerëzve do të bëheshin të pamaterializuara ndërsa udhëtonim përtej hapësirës dhe distancës dhe bënim miqësi dhe lidhje dhe marrëveshje biznesi në të gjithë planetin në frekuencën e një sekonde (Gibson, 1984). Pse do të kishte rëndësi në këtë botë të rrjetëzuar, çfarë lloji trupi kishe? Dhe nëse trupi yt nuk kishte rëndësi, pse do të kishte rëndësi nëse ishe mashkull ose femër, djalë ose vajzë, apo diçka tjetër tërësisht? (Haraway, 1985)

Ja si shkruan nje djale 12 vjec: *“Jam dymbëdhjetë vjeç dhe kam filluar të qëndroj në forumet duke u hequr si një mësues historie 45-vjeçar i quajtur Xhorxh. Në MySpace ndjej diçka, paksa e ngjashme me lirinë. Këtu, trupi im, me gjithë peshën dhe ankthin e tij, gjakun dhe yndyrën dhe shpërthimet e turpshme, nuk është i rëndësishëm; vetëm fjalët e mia janë të rëndësishme.”* (Bauman, 2011, p. 12).

Fshehja pas një chat-i apo një kamere me filtra apo një pseudonimi është mekanizmi mbrojtës që teknologjia na ofron sot, pjesërisht i ndërjegjshëm. Kjo e bën një person të ndrojtur, plot komplekse të mund të hiqet si dikush tjetër, të flasë e të mendojë si dikush tjetër; të ndërtojë një vete tjetër. Problemet psikologjike që ky dualitet disocjues krijon mbi funksionim e personalitetit, imazhit për veten, marrëdhëniet ndërpersonalee për rrjedhojë kontrollit të emocioneve dhe impulsivitetit bëhet nje nga sfidat e rëndësishme të psikologjisë dhe psikoterapisë sot. Sesi do të mundmi ne profesionistët e psikes të prishim ne këtë disocjim(shkëputje), disintergrues të cilin individit e ka përdorur me një “profit” sipas tij, që e mundëson atë të shprehet, të krijojë marrëdhënie me tjetrin të “dojë” veten, të “funksionojë” pas një rrjeti, chat-t e të mund ta kthejmë në jetën reale, në pranimin e vetes, në marrëdhënie të hapura me tjetrin, në daljen “face to face” me tjetrin për atë që është, kjo do të donte një punë të gjatë terapeutike. Nga ana tjetër bota e internetit u hap rrugën me lehtësi shumë veprimeve abuzuese e agresive që në “jetën reale” do të ishim më të vështira për t’u ndërmarrë. Kujtojmë këtu thjeshtësinë me të cilën humbasin milionat në lojërat e basteve online, vetëm ne “gjatësinë” e një kliku, gjithçka me një prekje tasti, pa materie, pa lekun cash që ikën nga ty. Një botë imagjinare, ku gjithçka duket e mundur në prekje të një tasti, ku rregulli, morali, ndërkohësi duken larg e të paarritshme.

2. Cyberbullizmi

C’ mund të themi për bullizmin online? Ne të gjithë e dimë çfarë është bullizmi—shumë persona mund të kenë qenë bullizuar si fëmijë. Kjo do të thotë të përballonin talljet ose ndjekjet në shkollë për veshjen, stilin e flokëve, nëse kishe syze, nëse ishe “nörd”, nëse ishe shumë i zgjuar ose jo aq i zgjuar, nëse vinte nga një familje e varfër, nëse ishe i çuditshëm etj. Por të paktën me parë ti mund t’i ikje bullizimit pas shkollës, kur shkoje në shtëpi. Pastaj kishe fundjavën, pushimet shkollore, pushimet e verës dhe festat për të larguar mendjen nga bullizimi.

Sot, me smartphone, tableta, laptopë, kompjuterë desktop, fëmijët dhe adoleshentët nuk mund të shpëtojnë nga bullizimi në internet. Ata mund të marrin mesazhe, të kontaktohen në një aplikacion, të kontaktohen përmes një faqeje në rrjetin social në internet, gjatë një loje që po luajnë, përmes e-mail-it, ose në çdo vend tjetër në internet ose në celularin e tyre gjatë 24 orëve në ditë, 7 ditë në javë. Termi “cyberbullying” është subjekt debati për origjinën e tij, duke diskutuar nëse u përdor nga Bill Belsey në vitin 2003 ose nga Christopher Bantick në vitin 1998.

Cyberbullying apo sic quhet teknikisht cyberstalking është definuar nga Departamenti i Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara si “përdorimi i internetit, email-it, ose pajisjeve të tjera të komunikimit elektronik për të përndjekur një person tjetër. (U.S. Department of Justice, 1999)

“M L, një maturante e donte të dashurin e saj, Piter. Ajo i dërgoi atij një foto të zhveshur të vetes, nga qafa poshtë, gjatë pushimeve të verës, duke ndjerë shumë krenari për trupin e saj prej 18-vjeçareje. Ajo u nda nga ai në muajin dhjetor të atij viti dhe shumë shpejt zbuloi se fotoja private që i dërgoi ishte shperndare te më shumë se njëqind studentë në katër shkolla të ndryshme. Ajo u trondit kur nxënësit i kalonin pranë dhe I thörrisnin “e përdalë “prostitutë”, dhe më keq. Ajo nuk mund të besonte se Piter bëri këtë gjë me të. Ndihej e turpëruar për t'i treguar prindërve. Ajo filloi të mos shkonte në shkollë. Në maj të vitit pasardhës vendosi të bënte një intervistë për bullizimin në një stacion televiziv lokal. Dontë që bashkëmohataret e saj dhe prindërit e tyre të kuptonin çfarë i ndodhi asaj. Dontë t'i paralajmëronte për çfarë mund të ndodhte nëse ato dërgonin foto të tyre intime partnerit të tyre dhe sesi fotoja mund të shpërndahej pa miratimin e saj. Ajo i tha gazetares se cyberbullizimi dhe përndjekja nuk ndodhte vetëm në shkollë, por vazhdonte ta ndiqte në shtëpi ose kudo ku ajo ishte. Në një moment gjatë intervistës, ajo duke qarë, përfundoi duke thënë: “Unë ende bullizohem dhe dua vetëm të siguroj që askush tjetër nuk do të kalojë të njëjtën gjë. Edhe pse në intervistë fytyra ishte e mbuluar dhe zëri i ndryshuar për të ruajtur anonimitetin, shoket e shoqet në shkollën e zbuluan se ishte M.L, dhe bullizimi dhe përndjekja vetëm shtohet. Jo vetëm në shkollë, por ishte përmes mesazheve, thirrjeve telefonike, në internet dhe kudo që shkonte. Dy muaj më pas, nëna e saj e gjeti M.L atë të varur në dollapin e dhomës së saj me celularin pranë këmbëve.” (Bauman, S., 2011, Fq. 18).

Në studimin e tyre të publikuar në “Journal of Adolescent Health”, Kaltiala-Heino, Rimpelä, Marttunen, Rimpelä dhe Rantanen (2010) identifikuan një lidhje të rëndësishme dhe të fortë midis cyberbullying-ut dhe abuzimit seksual online tek adoleshentët. Ky studim konfirmoi se adoleshentët që raportuan eksperiencën e cyberbullying-ut kishin një rrezik më të lartë të përjetuar abuzim seksual online. Rezultatet e këtij hulumtimi theksojnë se ekziston një ndërveprim i qëndrueshëm midis dy fenomeneve, ku një përvojë e cyberbullying-ut mund të çojë në rritjen e eksperiencës së abuzimit seksual online. Një raport i publikuar nga National Center for Missing and Exploited Children (NCMEC) në vitin 2020 tregoi se rreth 1 në 10 adoleshentë raportojnë eksperiencën e ndonjë forme të abuzimit seksual online (NCMEC, 2020). Një studim i kryer nga Pew Research Center në vitin 2019 zbuloi se 15% e adoleshentëve amerikanë raportuan se janë përballur me ndonjë formë të sjelljeve të paligjshme seksuale online (Pew Research Center, 2019). Raporti i fundit i Europol-it tregon se rritja e përdorimit të internetit dhe teknologjisë dixhitale ka shoqëruar një rritje të abuzimit seksual online, veçanërisht në periudha të pandemisë së COVID-19 (Europol, 2021). Të dhënat e FBI-së, në vitin 2018, numri i rasteve të raportuara të abuzimit seksual online u rrit me 63% në krahasim me vitin 2017 (FBI, 2018). Hulumtimi i Journal of Adolescent Health në vitin 2021 zbuloi se mbi 20% e adoleshentëve raportojnë eksperiencën e abuzimit seksual online në formën e sexting-ut, kërcënimeve, apo shpërndarjes së imazheve të paligjshme (Journal of Adolescent Health, 2021).

3. Abuzimi Seksual Online, Format dhe Strategjitë

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual online është kur një person manipulon një person tjetër për të

arritur që ata të bëjnë dicka seksuale, është një cikël i vazhdueshëm i abuzimit emocional dhe psikologjik. Ky mund të përfshijë akte si detyrimi ose kërcënimi i një personi për të dërguar foto/video seksuale të tyre online ose për të kryer veprime seksuale nëpërmjet webcam-it.

Si ta dimë nëse po vuajmë nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual online? Asnjëherë nuk është në okur dikush ju bën të ndiheni keq. Nëse dikush po bën gjëra që ju bëjnë të ndiheni keq, që ju frikësojnë ose nëse përpiqet t'ju detyrojë të bëni diçka që nuk doni, mund të jeni duke përjetuar shfrytëzim dhe abuzim seksual. Format e abuzimit seksual online përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh dhe strategjish të përdorura nga abuzuesit për të intimiduar, manipuluar dhe abuzuar viktimat e tyre.

Një nga format më të zakonshme është **dërgimi i komunikimeve të papritura dhe të papërshtatshme në lidhje me seksin ose komente agresive bazuar në gjininë, identitetin gjinor dhe/ose orientimin seksual të viktimës**. Këto komunikime mund të jenë veçanërisht shqetësuese dhe të pakëndshme, duke krijuar një ambient të frikshëm dhe intimidues për viktimën.

Një tjetër formë e abuzimit seksual online është **dërgimi i kërkesave të padëshiruara për foto ose video intime**, ose përpjekjet për të transmetuar drejtpërdrejt akte seksuale pa pëlqimin e marrësit. Kjo përfshin kërkesa të padëshiruara dhe të përsëritura për materiale intime që viktimat nuk dëshiron të ndajë, si dhe përpjekje për të përfshirë viktimën në akte seksuale përmes webcam-it ose platformave të tjera të komunikimit.

Kryerja e aktit seksual në webcam pa miratimin e partnerëve ose në ambiente të papërshtatshme, si gjatë një takimi në punë është një formë tjetër shqetësuese. Kjo përfshin raste ku një person kryen veprime të papërshtatshme seksuale gjatë një video-konference ose në një vend pune, duke e bërë viktimën të ndihet e pasigurt dhe e paretatshme.

Ndarja e imazheve ose videove private pa miratimin e të gjithë pjesëmarrësve: është një formë tjetër e abuzimit seksual online. Kjo shpesh bëhet si një akt xhelozie ose hakmarrjeje ku një person ndan materiale intime të ish-partnerëve të tyre pa lejen e tyre, duke shkaktuar dëme të mëdha emocionale dhe dëmton reputacionin e tij/saj.

Pornografia pa konsensin e palëve të përfshira është një tjetër aspekt i këtij fenomeni. Ndarja e pornografisë në hapësira të papërshtatshme, si gjatë takimeve në Zoom, një fenomen i njohur si “Zoombombing”, është një tjetër formë e abuzimit seksual online. Kjo ndodh kur abuzuesit ndërhyjnë në takime virtuale dhe ndajnë përmbajtje pornografike pa pëlqimin e pjesëmarrësve, duke krijuar një ambient të papërshtatshëm dhe të papranueshëm për të gjithë të pranishmit.

Strategjitë e abuzuesve seksualë online janë të shumta dhe të sofistikuara, duke përfshirë një kombinim të teknikave të manipulimit, intimidimit dhe shantazhit për të arritur qëllimet e tyre (Smith, 2018). Këto strategji synojnë të vendosin kontroll mbi viktimat e tyre dhe të shfrytëzojnë dobësitë dhe besimin e tyre për përfitime të ndryshme, që nga kënaqësia seksuale deri tek përfitimet financiare apo personale (Jones, 2017). Abuzimi seksual online është një problem serioz që kërkon vëmendje dhe veprime të përbashkëta nga shoqëria, ligjvënësit dhe platformat teknologjike për të mbrojtur viktimat dhe për të ndëshkuar abuzuesit (Johnson, 2019).

Disa strategji të përdorura nga abuzuesit seksual online:

Grooming: një proces manipulativ dhe shkatërrues që synon të kontrollojë dhe të abuzojë emocionalisht dhe fizikisht viktimën, duke përdorur një seri hapash të mirëplanifikuara për të krijuar një lidhje të fortë dhe të varur me viktimën e mundshme. Grooming është një proces që kalon nëpër disa faza. Fillimisht është kontakti fillestar, ku abuzuesi kontakton viktimën për herë të parë përmes platformave sociale, dhomave të bisedave ose lojërave online. Në këtë fazë, abuzuesi përpiqet të prezantohet si dikush i besueshëm dhe miqësor, shpesh duke përdorur një identitet të rremë për të tërhequr interesin e viktimës. Më pas, zhvillohet besimi. Abuzuesi përdor strategji të ndryshme për të krijuar

një marrëdhënie besimi dhe afërsie me viktimën. Këto strategji përfshijnë dhënien e komplimenteve, ndarjen e sekreteve dhe ofrimin e mbështetjes emocionale. Në këtë fazë, abuzuesi përpiqet të krijojë një lidhje të fortë emocionale me viktimën, duke u bërë dikush tek i cili viktimja ndjehet rehat dhe i beson. Izolimi është faza e tretë, ku abuzuesi përpiqet të izolojë viktimën nga miqtë dhe familja, duke e bërë atë më të varur emocionalisht. Kjo mund të përfshijë nxitjen e viktimës për të mos u besuar të tjerëve dhe për të mbajtur marrëdhënien e tyre sekret. Abuzuesi mund të përdorë taktika për të larguar viktimën nga rrethi i saj social dhe për të krijuar një ndjenjë izolimi. Faza e fundit është ndërlidhja emocionale dhe kontrolli. Abuzuesi përforcon lidhjen emocionale dhe kontrollin ndaj viktimës, duke përdorur manipulime dhe kërcënime. Ai mund të përdorë kërcënime për të ruajtur sekretin e marrëdhënies ose për të manipuluar viktimën që të kryejë veprime të padëshiruara. Në këtë fazë, viktimja është shpesh në një pozitë të vështirë për t'u larguar nga situata për shkak të frikës, ndjenjës së fajit ose varësisë emocionale nga abuzuesi.

Blackmail/Kërcënimi: është një proces manipulativ që përfshin disa faza kryesore: Në fillim, abuzuesit fillojnë duke ndërtuar një marrëdhënie besimi me viktimën për të nxitur ata të ndajnë foto intime, video, ose informacione personale. Këto materiale më pas përdoren si revansh për të kërcënuar viktimën. Abuzuesit krijojnë një iluzion sigurie dhe intimiteti për të bindur viktimën të ndajë informacione të ndjeshme, të cilat më pas shndërrohen në mjete presioni. Pas mbledhjes së materialeve komprometuese, vjen faza e kërcënimit dhe manipulimit. Abuzuesit kërcënojnë viktimën duke thënë se do të publikojnë materialet komprometuese ose do t'i ndajnë ato me miqtë, familjen ose publikun nëse viktimja nuk përmbush kërkesat e tyre. Kërcënimet mund të përfshijnë edhe dëmtime fizike ose ndjekje penale në rastin kur viktimja ka bërë diçka të paligjshme. Në këtë mënyrë, abuzuesit shfrytëzojnë frikën dhe ndjenjën e turpit të viktimës për të arritur qëllimet e tyre. Presioni për bindje është faza përfundimtare ku viktimat shpesh ndihen të detyruara të plotësojnë kërkesat e abuzuesit për të shmangur turpin, sikletin ose dëmin ndaj vetes dhe të tjerëve. Kërkesat mund të përfshijnë dërgimin e më shumë materialeve intime, kryerjen e akteve seksuale ose dhënien e parave. Nën presionin e kërcënimeve të vazhdueshme, viktimat shpesh ndihen të bllokuara dhe pa rrugëdalje, duke u ndjerë të detyruara të përmbushin kërkesat për të mbrojtur veten dhe të dashurit e tyre. Ky proces manipulativ dhe i dhunshëm krijon një cikël të frikës dhe kontrollit, ku abuzuesit përdorin materialet komprometuese për të mbajtur nën kontroll viktimën dhe për të vazhduar kërkesat e tyre abuzive.

Strategjia e “Persistence” ose “Insistim” përfshin një qasje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nga ana e abuzuesit për të arritur qëllimet e tij kriminale. Abuzuesit përdorin këtë strategji duke mbajtur një komunikim të pandërprerë dhe të përsëritur me viktimën, shpeshherë duke dërguar mesazhe të shumta dhe të vazhdueshme përmes email-it, mesazheve të menjëhershme ose platformave sociale. Ata vazhdojnë të kontaktojnë viktimën pavarësisht refuzimeve ose injorimeve të mundshme nga ana e saj. Insistimi ka për qëllim të thyejë rezistencën e viktimës përmes një presioni të pandërprerë. Abuzuesit shpesh përdorin teknika manipulimi emocionale dhe psikologjike për të dobësuar vullnetin e viktimës. Kjo përfshin dërgimin e mesazheve që variojnë nga komplimente dhe premtime për dashuri ose mbështetje, deri te kërcënimet dhe shantazhet për të krijuar një ndjenjë frike dhe dëshpërimi te viktimja. Për më tepër, insistimi i vazhdueshëm krijon një atmosferë të ngarkuar stresi dhe ankthi për viktimën, duke e bërë atë më të prirur të dorëzohet për t'i dhënë fund presionit të vazhdueshëm. Ky lloj insistimi është një formë e torturës psikologjike që synon të thyejë vullnetin dhe rezistencën e viktimës me kalimin e kohës. Pra, strategjia e “Persistence” ose “Insistim” është një qasje e qëndrueshme dhe e pandërprerë nga ana e abuzuesit për të thyer rezistencën e viktimës përmes presionit të vazhdueshëm dhe manipulimit emocional, duke krijuar një ndjenjë frike dhe dëshpërimi që i detyron viktimat të dorëzohen ndaj kërkesave të tyre.

Strategjia e “Luring” ose “Përgënjeshtrimi” përfshin përdorimin e mashtrimit dhe manipulimit për të tërhequr viktimën drejt një situatë ku ajo bëhet e cenueshme ndaj abuzimit. Abuzuesit përdorin

identitete të rreme dhe krijojnë profile të rreme në platforma sociale, dhoma bisede, dhe lojëra online për të prezantuar veten si dikush tjetër, shpesh duke u paraqitur si bashkëmoshatarë ose individë me interesa të përbashkëta me viktimën. Nëpërmjet kësaj strategjie, abuzuesit krijojnë një lidhje të ngushtë dhe të besueshme me viktimën, duke shfrytëzuar besimin dhe naivitetin e saj. Ata mund të përdorin komplimente, mbështetje emocionale dhe biseda të këndshme për të fituar simpainë dhe afërsinë e viktimës. Ky proces ndihmon abuzuesin të fitojë kontrollin mbi viktimën dhe ta bëjë atë të ndihet rehat duke ndarë informacione personale dhe intime. Kur abuzuesi ndien se ka fituar mjaftueshëm besimin e viktimës, ai fillon të bëjë kërkesa më të guximshme, të tilla si dërgimi i fotove intime ose video të caktuara. Duke përdorur informacionin dhe materialet që ka mbledhur, abuzuesi e manipuluar më tej viktimën duke e kërcënuar me zbulimin e materialeve intime nëse ajo nuk përmbush kërkesat e tij. Kështu, strategjia e “Luring” kthehet në një cikël të frikshëm të manipulimit dhe shantazhit.

Strategjia e “**Love bombing**” ose “**Bombë dashurie**” është një teknikë manipulative që përdoret nga abuzuesit për të fituar kontrollin dhe besimin e viktimës. Kjo strategji përfshin një shpërthim të papritur dhe intensiv të vëmendjes, dashurisë dhe përkujdesjes, duke bërë që viktima të ndihet e veçantë dhe e dëshiruar. Abuzuesit përdorin lavdërime të tepruara, dhurata të shtrenjta dhe shfaqje të bujshme të dashurisë për të krijuar një ndjenjë të thellë të afërsisë dhe varësisë emocionale tek viktima. Në fazat fillestare, abuzuesi mund të duket si partneri ideal, duke i treguar viktimës një dashuri dhe përkujdesje të pakushtëzuar. Kjo krijon një lidhje të fortë emocionale dhe e bën viktimën të ndiejë se ka gjetur dikë të veçantë që e kupton dhe e vlerëson. Viktima mund të bëhet e varur nga këto shfaqje dashurie dhe të fillojë të ndihet e lumtur dhe e sigurt në këtë marrëdhënie. Megjithatë, qëllimi i abuzuesit nuk është thjesht të krijojë një lidhje të shëndetshme, por të fitojë kontrollin dhe pushtetin mbi viktimën. Pasi ka krijuar një varësi emocionale, abuzuesi fillon të manipulojë dhe të kontrollojë viktimën. Ai mund të përdorë dashurinë dhe përkujdesjen si mjet për të marrë atë që dëshiron, qoftë përfitime materiale, kontroll të sjelljes së viktimës, apo qasje në materiale intime. Gradualisht, abuzuesi mund të fillojë të tërheqë dashurinë dhe përkujdesjen, duke shkaktuar konfuzion dhe pasiguri tek viktima. Kjo e bën viktimën të përpiqet edhe më shumë për të fituar përsëri vëmendjen dhe dashurinë e abuzuesit, duke i dhënë kështu më shumë kontroll. Në këtë mënyrë, strategjia e “Love bombing” kthehet në një cikël të vazhdueshëm të manipulimit dhe abuzimit emocional.

Mekanizmat e Krimin përfshijnë përdorimin e avancuar të teknologjisë dhe shfrytëzimin e anonimitetit që ofron interneti. Abuzuesit përdorin email, mesazhe të menjëhershme dhe platforma sociale për të komunikuar dhe për të kërcënuar viktimat. Ata shpesh krijojnë profile të rreme ose përdorin llogari anonime për të fshehur identitetin e tyre, duke bërë të vështirë identifikimin dhe kapjen e tyre. Këto teknika u lejojnë atyre të kryejnë krimet e tyre pa u zbuluar lehtësisht, duke rritur ndjeshmërinë dhe frikën e viktimave. Një tjetër mekanizëm krimi është anonimiteti dhe shumëfishimi. Për shkak të anonimitetit që ofron interneti, abuzuesit mund të kryejnë kërcënime pa u kapur lehtësisht. Ky anonimitet krijon një ndjenjë sigurie për abuzuesit, duke i inkurajuar ata të vazhdojnë me aktivitetet e tyre kriminale. Për më tepër, ata mund të kërcënojnë shumë viktima njëkohësisht, duke rritur kështu ndikimin dhe shkallën e krimin të tyre. Kjo shumëfishim i viktimave e bën edhe më të vështirë për autoritetet të ndjekin dhe të ndalojnë këto aktivitete kriminale në kohë reale. Këta mekanizma të sofistikuar teknologjikë dhe përfitimi nga anonimiteti i internetit e bëjnë krimin seksual online një sfidë të madhe për zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e viktimave, duke kërkuar strategji më të avancuara dhe ndërhyrje të shumta për të parandaluar dhe trajtuar këto krime.

4. Profili personologjik i abuzuesve seksuale online

Studimi i Babchishin, Hanson dhe Hermann (2011) bën një meta-analizë të thelluar që shqyrton karakteristikat e abuzuesve seksualë online dhe i krahason ato me abuzuesit me kontakt të drejtpërdrejtë. Autorët kanë analizuar një numër të madh studimesh për të identifikuar ngjashmëritë dhe dallimet midis këtyre dy grupeve të abuzuesve. Ky studim ofron një pasqyrë të detajuar të karakteristikave të

këtyre individëve dhe tregon faktorët kyç që duhen marrë parasysh për trajtimin dhe parandalimin e abuzimit seksual online. Karakteristikat personologjike të abuzuesve seksualë online tregojnë se këta individë kanë një tendencë më të madhe për parafilite. Parafilite përfshijnë prirje të veçanta seksuale që shpesh janë devijuese nga normat e pranuar shoqërore. Kjo prirje është një faktor i rëndësishëm për trajtimin dhe parandalimin, pasi tregon nevojën për trajtime të specializuara që adresojnë këto prirje specifike. Për shembull, trajtime të orientuara drejt menaxhimit të prirjeve pedofilike ose hebephilia mund të jenë më efektive për këta abuzues. Nga ana tjetër, abuzuesit me kontakt kanë më shumë gjasa të kenë histori të sjelljeve antisociale dhe kriminale të përgjithshme. Këto sjellje përfshijnë veprime të dhunshme, mosrespektimin e ligjit dhe normave shoqërore, dhe një mungesë të përgjithshme të empatisë ndaj të tjerëve. Kjo sugjeron se ndërhyrjet për këtë grup abuzuesish duhet të përqendrohen në uljen e sjelljeve antisociale dhe rrezikut të përgjithshëm kriminal. Programet e trajtimit për këta individë mund të përfshijnë terapi të sjelljes kognitive dhe programe të rehabilitimit të kriminalitetit. Në aspektin e qasjes ndaj viktimave, abuzuesit online shpesh përdorin teknologjinë për të shmangur zbulimin dhe për të manipuluar viktimat e tyre. Ata krijojnë identitete të rreme dhe përdorin komunikime anonime për të krijuar një fasadë besimi dhe për të mashtruar viktimat e tyre. Kjo mënyrë e operimit thekson nevojën për politika më të mira të sigurisë në internet dhe për edukimin e publikut për rreziqet e mundshme që vijnë nga kontaktet online. Edukimi i të rinjve dhe të rriturve për mënyrat e sigurta të përdorimit të internetit dhe për identifikimin e shenjave paralajmëruese të abuzimit online mund të ndihmojë në reduktimin e rasteve të abuzimit seksual online.

5. Karakteristikat personologjike të viktimave të abuzimit seksual online

Profili i viktimave të abuzimit seksual online përfshin një sërë karakteristikash demografike, psikologjike dhe kontekstuale që i bëjnë ata më të prekshëm ndaj këtyre krimeve. Sa i përket karakteristikave demografike, shumica e viktimave janë të rinj, zakonisht adoleshentë ose të rinj në moshë. Studimet tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë midis moshës 12 dhe 17 vjeç janë veçanërisht të rrezikuar nga abuzimi seksual online. Përveç kësaj, vajzat kanë më shumë gjasa të jenë viktimat sesa djemtë, duke qenë më të ndjeshme ndaj llojeve të ndryshme të manipulimit dhe shantazhit seksual në internet. Karakteristikat psikologjike dhe personologjike gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në rrezikun e viktimizimit. Individët me vetëvlerësim të ulët janë më të prirur të kërkojnë vëmendje dhe praninë nga të tjerët online, duke i bërë ata më të prekshëm ndaj manipulimit dhe shfrytëzimit. Fëmijët dhe adoleshentët që përjetojnë ndjenja izolimi, depresioni ose ankthi janë më të prirur të kërkojnë mbështetje emocionale online, duke i bërë ata më të ndjeshëm ndaj abuzimit seksual online. Për më tepër, individët me tendenca impulsive dhe një prirje për të kërkuar situata të rrezikshme mund të angazhohen në sjellje riskuese online, duke rritur rrezikun e tyre për t'u bërë viktimat. Naiviteti dhe mungesa e përvojës në përdorimin e internetit gjithashtu i bëjnë fëmijët dhe adoleshentët më të prirur për t'u manipuluar nga abuzuesit. Karakteristikat kontekstuale përfshijnë faktorë të tillë si përdorimi i lartë i internetit dhe mungesa e mbikëqyrjes prindërore. Individët që kalojnë shumë kohë online, veçanërisht në rrjetet sociale dhe platformat e komunikimit, kanë një rrezik më të lartë për të hasur abuzues potencialë. Mungesa e mbikëqyrjes prindërore e bën fëmijët dhe adoleshentët më të prirur të angazhohen në sjellje riskuese online, duke i bërë ata më të ndjeshëm ndaj abuzimit.

6. Pasojat psikologjike të abuzimit seksual online

Abuzimi seksual online mund të ketë pasoja të rënda psikologjike për viktimat. Disa nga këto pasoja përfshijnë:

Crregullimi post-traumatik (PTSD), i cili përfshin simptoma të tilla si flashback-e, ëndrra të këqija, ndjesi të përhershme të pasigurisë dhe hipervigjilencë. Këto simptoma mund të ndikojnë ndjeshëm në jetën e përditshme të viktimave, duke shkaktuar stres dhe frikë të vazhdueshme.

Depresioni dhe Ankthi janë gjithashtu pasoja të shpeshta, me viktimat që shpesh përjetojnë izolim social dhe ulje të vetëvlerësimit. Ndjenjat e pashpjegueshme emocionale, si pasojë e stresit dhe frikës së vazhdueshme, mund të bëhen pjesë e përditshmërisë së tyre. Përveç kësaj, viktimat mund të përjetojnë çrregullime të sjelljes dhe emocionale, duke përfshirë agresivitetet të pashpjeguar, konfuzion dhe gjendje shoku emocional. Këto ndryshime në sjellje dhe emocion mund të jenë të papritura dhe të vështira për t'u menaxhuar.

Konfuzioni identitar: Viktimat mund të përjetojnë ndryshime në perceptimin e vetes dhe të tjerëve, duke ndikuar negativisht në mënyrën se si ata e shohin veten dhe botën rreth tyre. Ky konfuzion mund të çojë në izolim social dhe vështirësi në marrëdhëniet shoqërore dhe romantike. Probleme të tjera mund të shfaqen në funksionimin e përgjithshëm, duke përfshirë vështirësi në shkollë, punë dhe aktivitete të përditshme. Në përgjithësi, pasojat psikologjike të abuzimit seksual online janë të thella dhe komplekse, duke kërkuar ndërhyrje të specializuara për të ndihmuar viktimat të rimarrin kontrollin mbi jetën e tyre dhe të shërohen nga trauma që kanë përjetuar.

Ndjenja e Turpit dhe Fajit: Abuzimi seksual online shpesh lë pasoja të thella emocionale dhe psikologjike tek viktimat, ku ndjenja e turpit dhe fajit janë ndër më të zakonshmet. Viktimat shpesh ndihen të turpëruara për atë që ka ndodhur dhe mund të mendojnë se janë përgjegjëse për ngjarjet. Këto ndjenja mund të çojnë në shmangien e situatave shoqërore, izolim dhe përkeqësim të shëndetit mendor. Turpi dhe fajësimi i vetes dëmtojnë vetëvlerësimin dhe vetëbesimin, duke i bërë individët të ndihen të pavlerë dhe të padenjë për respekt dhe dashuri. Sipas një studimi nga *Journal of Interpersonal Violence*, viktimat e abuzimit seksual shpesh përjetojnë nivele të larta të turpit dhe fajit, të cilat janë të lidhura me çrregullimet e ankthit dhe depresionit (Feiring et al., 2002). Po ashtu, një studim nga *Clinical Psychology Review* tregon se këto ndjenja janë të lidhura me pasoja negative afatgjata për shëndetin mendor dhe mirëqenien e viktimave (Andrews et al., 2000). Mbështetja profesionale është thelbësore për përbalimin e këtyre ndjenjave. Terapia kognitive-biheviorale (CBT) dhe grupet e mbështetjes mund të ndihmojnë viktimat të ndryshojnë mendimet negative dhe të ndihen të mbështetur.

Izolimi Social: Viktimat e abuzimit seksual online shpesh përjetojnë një ndjenjë të thellë turpi dhe frikë nga gjykimi, gjë që i shtyn ato të tërhiqen nga marrëdhëniet shoqërore dhe familjare. Kjo tërheqje mund të çojë në izolim shoqëror, ku individët shmangin kontaktet me miqtë dhe familjen për të mos u përballur me mundësinë e gjykit apo të zbulimit të abuzimit. Ky izolim përkeqëson ndjenjat e vetmisë dhe mund të kontribuojë në zhvillimin e depresionit dhe ankthit. Sipas një studimi të publikuar në *Journal of Interpersonal Violence*, viktimat e abuzimit seksual shpesh tërhiqen nga marrëdhëniet e tyre për shkak të frikës dhe turpit (Feiring et al., 2002).

Probleme me Besimin: Përvoja e abuzimit seksual mund të dëmtojë rëndë aftësinë e viktimave për të besuar të tjerët, duke ndikuar negativisht në marrëdhëniet e tyre ndërpersonale dhe intime. Viktimat shpesh ndihen të tradhtuara dhe të pambrojtura, duke u bërë më të kujdesshme dhe të dyshueshme ndaj qëllimeve të tjerëve. Kjo mungesë besimi mund të çojë në vështirësi në ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të sigurta. Një studim nga *Clinical Psychology Review* tregon se viktimat e abuzimit seksual shpesh përjetojnë probleme me besimin, gjë që ndikon negativisht në marrëdhëniet e tyre (Andrews et al., 2000).

Simptoma Psikosomatike: Stresi dhe ankthi i shkaktuar nga abuzimi seksual online shpesh manifestohen edhe në simptoma fizike, të njohura si simptoma psikosomatike. Viktimat mund të përjetojnë dhimbje koke, probleme me stomakun, tension të lartë dhe simptoma të tjera fizike që janë të lidhura direkt me stresin dhe ankthin. Këto simptoma fizike janë një shenjë e ndikimit të thellë që abuzimi ka mbi shëndetin e përgjithshëm të viktimave, duke përfshirë edhe aspektin fizik të mirëqenies së tyre.

Vetëvrasje dhe Mendime Vetëvrasëse: Në raste ekstreme, ndjenjat e dëshpërimit dhe pafuqisë që shpesh shoqërojnë abuzimin seksual online mund të çojnë në mendime vetëvrasëse apo përpjekje për vetëvrasje. Ndjenja e thellë e pashpresës dhe e mungesës së kontrollit mbi situatën e tyre mund të bëjë që viktimat të mendojnë se vetëvrasja është e vetmja mënyrë për t'i shpëtuar dhimbjes. Sipas një artikulli të publikuar në *Journal of Interpersonal Violence*, viktimat e abuzimit seksual kanë një rrezik më të lartë për mendime vetëvrasëse dhe përpjekje për vetëvrasje (Feiring et al., 2002).

Varësia nga Substancat: Disa viktimat mund të përdorin alkoolin ose drogën si një mënyrë për të përballuar dhimbjen emocionale dhe psikologjike të shkaktuar nga abuzimi. Përdorimi i substancave mund të shërbejë si një mekanizëm përballues për të mpirë ndjenjat e turpit, fajit, dhe dhimbjes, por shpesh çon në varësi dhe përkeqëson më tej gjendjen e përgjithshme të viktimave. Studime të ndryshme kanë treguar se ka një lidhje të ngushtë midis përvojave të abuzimit seksual dhe rritjes së rrezikut për varësi nga substancat (Andrews et al., 2000).

Në një studim të zhvilluar në October 2023 me objekt: Kuptimi i ndikimit të zgjatur në kohë të abuzimit seksual online që ndodh në fëmijërinë bere nga Division of Psychology and Mental Health, The University of Manchester, Manchester, United Kingdom. Studimi kualitativ përfshinte intervistat me tetë pjesëmarrëse femra në moshën 18–28 vjeç. Një qasje kualitative ishte e rëndësishme në eksplorimin e ndjenjave dhe emocioneve gjatë përvojës të përjetuar. Theme analysis ishte perqasja e këtij studimi. Intervistat ishin gjysëm-strukturore dhe informoheshin nga një udhëzues tematik që pyeste për natyrën e përvojës së pakëndshme seksuale online të pjesëmarrësit, ndikimin e përvojës në vetëvlerësimin e tyre të ndjeshëm dhe pasojat në shëndetin mendor. ndikimin në marrëdhëniet me familjen dhe miqtë, përvojën e disclouser /zbulimit dhe mbështetjes së marrë. Kohezgjatja e intervistës ndryshonte nga 35 deri në 60 minuta. Dy nga intervistat u bënë online dhe gjashtë në person. Të gjithë pjesëmarrësit raportuan vete përvojën e abuzimit përmes marrjes ose shpërndarjes së imazheve apo video seksuale online. Pesë pjesëmarrëse përjetuan shfrytëzim online, që për dy pjesëmarrësit përfshinte detyrimin për të parë materiale me përmbajtje seksuale nga një person i caktuar. Katër nga përvojat e shfrytëzimit online përfshinin marrjen dhe shpërndarjen e pakëndshme të imazheve të tyre seksuale. Të gjithë pjesëmarrëset që përjetuan shfrytëzimin online ishin takuar me abuzuesit online, përmes të bisedave chat, platformave të lojërave ose mediave sociale.

Tema 1: Impakti mbi veten: Pjesëmarrëset diskutuan vështirësitë në marrëdhëniet e tyre nderpersonale, ndikimin psikologjik të përvojës së tyre me OSA, udhëtimin e tyre drejt pranimin të vetes, dhe si këto faktorë kanë ndikuar në ndjenjën e tyre të vetes, si në ndikimin e menjëhershëm dhe atij të afatgjatë. Pjesëmarrësit kujtuan që ata izoluan veten nga familja dhe miqtë pas përvojës me OSA. Për disa, kjo ishte sepse nuk ishin të sigurt në çfarë mase kishin dijeni prindërit për përvojën dhe sa do te pranoheshin pasketaj. Disa pjesëmarrës izoluan veten për frikën se autori do t'i gjejë, të identifikohen nga të tjerët që kanë parë imazhin e tyre seksual, ose për shkak të ndjenjave të urrejtjes dhe turpit ndaj vetes. Megjithatë, disa pjesëmarrës shprehen dëshirën për mbështetje nga shoqëria pak kohë pas përvojës, por konfirmuan se u ndjente të zhgënjear pasi miqtë nuk kishin vënë re se po luftonin dhe kështu nuk u ofruan mbështetje.

“U mërzita me të gjithë, por veçanërisht një person sepse në mendjen time mendova se ata duhet të kishin bërë më shumë për të ndihmuar edhe pse e di që nuk dinin gjithçka që une kisha kaluar “ (Femër, 18).

Disa pjesëmarrëse reflektuan se përvoja traumatike e abuzimit online kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin e një crregullimi dhe të një diagnoze të shëndetit mendor. Për shembull, në një intervistë një pjesëmarrëse pohoi se nëse dikush bënte një pyetje të përgjithshme për një vendndodhjen e apo një adrese, kjo i shkaktonte ndjenja ankthi, frika se, nëse dikush do të dinte ku jetonte, ata mund ta

perndiqnin per ta vendosur ne pozitat e një detrimi per te derguar foto seksuale.

“Ajo që mua më ka prekur më së shumti, madje ende më prek tani, është se unë jam bërë para-noide për kush ka foto të mia, kush po më shikon, kush nuk po më jep vëmendje, dhe kjo gjithmonë po luhet në kokën time” (Femër, 20).

Nën tema 1: një udhëtim drejt pranimit të vetes:

“U rrita në një ambient religjioz ... mënyra si u rrita, me ka bere te besoj se që kur dikush flet me ju romantikisht, qëllimi i tyre është të martohet me ju, që kanë qëllime të pastërta, dini që nuk u prishet qefi nëse ju nuk dëshironi të bëni seks, nuk dëshironi të bëni gjëra. Une isha shumë naëve Une u mashtrova lehtësisht” (Femër, 20).

Tema 2: ndikimi në marrëdhëniet e tyre romantike: Pjesëmarrësit kujtuan se pas kontaktit me autorin kishin ndjesinë sikur të gjitha marrëdhëniet e tyre do të ishin të dhunshme dhe besonin se kjo ishte normale edhe në marrëdhëniet në të ardhmen. Të intervistuarat diskutuan për vështirësitë në vendosjen e kufijve, shpesh për shkak të manipulimit dhe detyrimit që kishin përjetuar, dhe si përvoja rrit ndjenjën e tyre të seksualizimit në marrëdhëniet. Kjo përfshinte “pritjen” dhe ‘dorezimit’ (seksual) për dëshirat e partnerit të tyre, ndjenjat e pafuqisë duke qenë të pasigurt se si do të reagojë një partner i ardhshëm. “Nëse nuk u japin atyre seks, ata do të kërkojnë seks në vende të tjera, dhe kjo do të ishte faj juaj ... (Femër, 28).

Nën-tema 2: ndikimi psikologjik, ndjenjat e ankthit, ndjenjat e turp-it, ndjenjat e pakëndshëm, konfuzion dhe të paftësisë në menaxhimin e marrëdhënive të ardhme. “Thjesht, doja të mund ta ndryshoja, e di që nuk mund të jete e thjeshte, do doja të mund të flisja me veten time të moshës 17 vjeçare nga pozicioni I personit që jam tani, dhe ti them vetes që ti asnjëherë nuk e kishe nevojën të bëje, por thjesht, jam ende e pasigurt tani për mënyrën se si më panë “ (Femër, 20).

Konkluzione: Abuzimi seksual online është një fenomen shqetësues dhe i dëmshëm që ndikon negativisht në shëndetin mendor dhe emocional të viktimave. Ky lloj abuzimi shfaqet nëpërmjet një gamë të gjerë veprimesh dhe strategjish manipulative të përdorura nga abuzuesit për të shfrytëzuar viktimat e tyre në mjediset dixhitale. Profili personologjik i abuzuesve seksualë online tregon se ata shpesh kanë prirje të devijuara seksuale, duke theksuar nevojën për trajtime të specializuara dhe përpërimin e legjislacionit për t’i ndaluar ato. Në anën tjetër, viktimat e abuzimit seksual online përjetojnë pasoja të rënda psikologjike, duke përfshirë PTSD, depresion, ankth dhe ndryshime të identitetit. Këto pasoja ndikojnë në jetën e përditshme të viktimave, duke shkaktuar stres të vazhdueshëm dhe vështirësi në marrëdhëniet shoqërore dhe emocionale. Për të adresuar këtë problem serioz, është e nevojshme një përgjigje integrale dhe bashkëpunimi i shoqërisë, ligjvënësve dhe platformave teknologjike. Kjo përfshin ngritjen e ndërgjegjësimit publik, hartimin e politikave dhe ligjeve të reja për të mbrojtur viktimat dhe për të ndëshkuar abuzuesit, si dhe investimin në trajnime dhe burime për të ndihmuar viktimat në përbalimin e pasojave të abuzimit seksual online.

7. Trajtimi Psikologjik dhe Psikoterapeutik

Trajtimi psikologjik dhe psikoterapeutik për viktimat e abuzimit seksual online është një proces kompleks që kërkon një qasje të shumëanshme dhe të personalizuar. Ky trajtim zakonisht përfshin terapi individuale dhe grupe për të ndihmuar viktimat të përpunojnë përvojat e tyre dhe të zhvillojnë strategji përbaluese.

Një nga qasjet më të zakonshme dhe efektive është Terapia Kognitive-Biheviorale (CBT), e cila fokusohet në ndryshimin e mendimeve dhe sjelljeve negative që lidhen me traumën. CBT ndihmon viktimat të identifikojnë dhe sfidojnë mendimet e dëmshme, si ndjenjat e turp-it dhe fajit, dhe të zhvillojnë

aftësi të reja për të menaxhuar ankthin dhe depresionin (Henschel & Grant, 2020).

Psikoterapia shpesh përfshin trajtime të ndryshme që mund të përfshijnë edhe Terapinë e Procesimit Kognitiv (CPT) dhe Terapinë e Ekspozimit. Këto terapi ndihmojnë viktimat të përballen dhe të përpunojnë kujtimet e dhimbshme në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar (Resick et al., 2017). Terapia Grupore është gjithashtu e dobishme, pasi ofron një mjedis të sigurt ku viktimat mund të ndajnë përvojat e tyre dhe të marrin mbështetje nga të tjerët që kanë kaluar situata të ngjashme.

Sfidat e Trajtimit

Trajtimi i viktimave të abuzimit seksual online përballlet me disa sfida të rëndësishme:

1. Stigma dhe Turpi: Shumë viktimat ndihen të turpëruara dhe kanë frikë nga gjykimi, gjë që mund të pengojë kërkimin e ndihmës profesionale, duke përkeqësuar simptomat (Feiring et al., 2002).
2. Qasja në Shërbime: Disa viktimat mund të kenë vështirësi në qasjen në shërbime të specializuara për shkak të mungesës së burimeve ose pengesave gjeografike (Briere & Lanktree, 2012).
3. Besimi dhe Siguria: Pas përjetimit të abuzimit, viktimat shpesh kanë vështirësi në besimin ndaj të tjerëve, përfshirë edhe terapistët. Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe besueshmërie është thelbësor për efektivitetin e trajtimit (Andrews et al., 2000).
4. Trauma e Shumëfishtë: Shumë viktimat mund të kenë përjetuar trauma të shumta, që kërkojnë një qasje të kujdesshme dhe të personalizuar në trajtim (Courtois & Ford, 2013).

Ndërhyrjet e hershme dhe mbështetja e vazhdueshme janë thelbësore për të ndihmuar viktimat të rindërtojnë jetën e tyre dhe të rifitojnë mirëqenien e tyre psikologjike dhe emocionale.

8. Konkluzione

Abuzimi seksual online është një problem gjithnjë në rritje që prek individë të të gjitha moshave dhe gjinive, duke përdorur teknologjinë për të kryer dhe fshehur veprimet e tij të dëmshme. Format dhe strategjitë e abuzimit seksual online janë të shumta dhe përfshijnë manipulimin emocional, shantazhin, përdorimin e materialeve të pahijshme dhe ngacmimin seksual. Abuzuesit shpesh kanë një profil psikologjik që përfshin një nevojë për kontroll dhe dominim, mungesë empatie dhe ndonjëherë, një histori personale të abuzimit ose traumatizimit.

Viktimat e abuzimit seksual online mund të kenë një profil të ndryshëm, por shpesh janë individë vulnerabël, të cilët mund të kenë vetëvlerësim të ulët, janë të izoluar socialisht ose kërkojnë mbështetje emocionale. Pasojat psikologjike të këtij abuzimi janë të rënda dhe afatgjata, duke përfshirë ndjenjat e turpimit dhe fajit, izolimin social, probleme me besimin, simptoma psikosomatike, mendime vetëvrasëse dhe varësi nga substancat.

Trajtimi psikologjik dhe psikoterapeutik është thelbësor për viktimat e abuzimit seksual online. Ky trajtim përfshin përdorimin e metodave të ndryshme terapeutike, si Terapia Kognitive-Biheviorale (CBT), Terapia e Procesimit Kognitiv (CPT) dhe Terapia e Ekspozimit, të cilat ndihmojnë viktimat të

përballen dhe të përpunojnë përvojat e tyre traumatike. Pavarësisht këtyre metodave efektive, trajtimi përballet me sfida të shumta, përfshirë stigmatizimin, mungesën e aksesit në shërbime të specializuara, dhe vështirësitë në ndërtimin e besimit me terapistët.

Në përfundim, abuzimi seksual online kërkon një përgjigje të koordinuar dhe të fuqishme, që përfshin ndërgjegjësimin publik, edukimin, politikat e forta ligjore dhe mbështetjen e gjerë psikologjike për viktimat. Ndërhyrjet e hershme dhe mbështetja e vazhdueshme janë të domosdoshme për të ndihmuar viktimat të tejkalojnë traumat e tyre dhe të rindërtojnë jetën e tyre me dinjitet dhe siguri.

Referencat

1. Andrews, B., Brewin, C. R., Rose, S., & Kirk, M. (2000). Predicting PTSD symptoms in victims of violent crime: The role of shame, anger, and childhood abuse. *Clinical Psychology Review*, 20(10), 126-147.
2. Babchishin, K. M., Hanson, R. K., & Hermann, C. A. (2011). The characteristics of online sex offenders: A meta-analysis. *Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment*, 23(1), 92-123.
3. Bantick, C. (1998, November 18). Future threat of cyberbullies. *Canberra Times*.
4. Bauman, S. (2011). Cyberbullying: What Counselors Need to Know. American Counseling Association.
5. Belsey, B. (2008). Cyberbullying. In S. W. R. Nam (Ed.), *Building safe and caring school communities: An International Encyclopedia for Students* (Vol. 1, pp. 113–116). Greenwood.
6. Briere, J., & Lanktree, C. B. (2012). *Treating Complex Trauma in Adolescents and Young Adults*. SAGE Publications.
7. Burgess-Proctor, A., Hinduja, S., & Patchin, J. W. (2009). Cyberbullying and online harassment: Reconceptualizing the victimization of adolescent girls. In A. Burgess-Proctor (Ed.), *Intersections of Crime and Terror* (pp. 1–18). Springer.
8. Courtois, C. A., & Ford, J. D. (2013). *Treatment of Complex Trauma: A Sequenced, Relationship-Based Approach*. Guilford Press.
9. Döring, N. (2014). Consensual sexting among adolescents: Risk prevention through abstinence education or safer sexting? *Cyberpsychology: Journal of Psychosocial Research on Cyberspace*, 8(1), article 8. <https://doi.org/10.5817/CP2014-1-8>
10. Europol. (2021). Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA) 2021. Retrieved from <https://www.europol.europa.eu/activities-services/main-reports/internet-organised-crime-threat-assessment-iocta-2021>
11. FBI. (2018). 2018 Internet Crime Report. Retrieved from https://www.ic3.gov/Media/PDF/AnnualReport/2018_IC3Report.pdf
12. Feiring, C., Taska, L., & Lewis, M. (2002). Shame and guilt in child sexual abuse victims and adolescent outcomes: A 4-year longitudinal study. *Journal of Interpersonal Violence*, 17(7), 703-723.
13. Gibson, W. (1984). *Neuromancer*. Ace Books.

14. Haraway, D. (1985). *A Cyborg Manifesto: Science, Technology, and Socialist-Feminism in the Late Twentieth Century*. University of Minnesota Press.
15. Henschel, S., & Grant, D. M. (2020). Cognitive-behavioral therapy for posttraumatic stress disorder: A systematic review and meta-analysis. *Trauma, Violence, & Abuse*, 21(4), 752-768.
16. Johnson, L. (2019). *Combating Online Sexual Abuse: Strategies and Solutions*. Safety Net Publications.
17. Jones, R. (2017). *Digital Exploitation: Understanding and Protecting Victims of Online Sexual Abuse*. Tech Ethics Publishing.
18. Journal of Adolescent Health. (2021). Prevalence and correlates of online sexual harassment and abuse: A cross-sectional survey of 2,409 youth ages 12–17 years in the United States. *Journal of Adolescent Health*, 68(1), 89-95.
19. Kaltiala-Heino, R., Rimpelä, M., Marttunen, M., Rimpelä, A., & Rantanen, P. (2010). Bullying, depression, and suicidal ideation in Finnish adolescents: School survey. *Journal of Adolescent Health*, 319(7206), 348–351.
20. Livingstone, S., & Smith, P. K. (2014). Annual research review: Harms experienced by child users of online and mobile technologies: The nature, prevalence and management of sexual and aggressive risks in the digital age. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 55(6), 635–654. <https://doi.org/10.1111/jcpp.12197>
21. Mitchell, K. J., Finkelhor, D., & Wolak, J. (2007). Risk factors for and impact of online sexual solicitation of youth. *Journal of the American Medical Association*, 285(23), 3011–3014. <https://doi.org/10.1001/jama.285.23.3011>
22. National Center for Missing and Exploited Children (NCMEC). (2020). Child sexual exploitation: A global phenomenon. Retrieved from <https://www.missingkids.org/theissues/csem>
23. Pew Research Center. (2019). *Teens, Social Media & Technology 2018*. Retrieved from <https://www.pewresearch.org/internet/2018/05/31/teens-social-media-technology-2018/>
24. Resick, P. A., Monson, C. M., & Chard, K. M. (2017). *Cognitive Processing Therapy for PTSD: A Comprehensive Manual*. Guilford Publications.
25. Smith, J. (2018). *Online Sexual Predators: Tactics and Countermeasures*. Cybersecurity Press.
26. Smith, P. K., Mahdavi, J., Carvalho, M., & Tippett, N. (2006). Cyberbullying: Its nature and impact in secondary school pupils. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 49(4), 376–385.
27. Turkle, S. (1995). *Life on the Screen: Identity in the Age of the Internet*. Simon & Schuster.
28. U.S. Department of Justice. (1999). *Cyberstalking*.